



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 39 Prot.

Tiranë, më 24.05.2016

V E N D I M
Nr. 61, datë 24.05.2016

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 39/1, datë 22.01.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit të dhënë prej Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për rastin e nëpunëses *****,

VËREJ SE,

Nëpërmjet një kërkesë që është protokolluar pranë Komisionerit me nr. 39 prot., datë 18.01.2016, nga ana e nëpunëses së Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve, ***** , ish Përgjegjëse e Sektorit të Kontrollit Tatimor dhe Verifikimit në Terren në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, është ngritur pretendimi se ndaj saj janë zhvilluar disa ecuri disiplinore të paligjshme, në shkelje të procedurës ligjore dhe të pa mbështetura në fakte të vërteta dhe në ligj, duke nëpërkëmbur në këtë mënyrë, të drejtat e saj si nëpunëse civile. Nisur nga ky informacion, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke vlerësuar se në këtë rast ka dyshime të arsyeshme për cënimin e të drejtave të kësaj nëpunëseje, të cilat garantohen nga legjislacioni i shërbimit civil, me aktin nr. 39/1 prot., datë 22.01.2016, ka urdhëruar nisjen e hetimit për verifikimin e ligjshmërisë së procesit administrativ të kryer.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të mbledhur në kuadër të këtij hetimi administrativ, ka rezultuar se, gjatë periudhës 17 shtator 2015, deri në 30 dhjetor 2015, ndaj kësaj nëpunëse janë zhvilluar tre procedime disiplinore, të cilat kanë përfunduar me vendimin nr. 1033, datë 30.12.2015, me të cilin është vendosur dhënia e masës disiplinore "Largim nga shërbimi civil".

Duke verifikuar procedurën e ndjekur në kryerjen e kësaj ecurie disiplinore, rezulton sa më poshtë:

- Me shkresën nr. 24516/5 prot., datë 17.09.2015 “*Fillim ecurie disiplinore*”, eprori direkt i nëpunëses *****, ka filluar një procedurë disiplinore duke përcaktuar se seanca dëgjimore për këtë ecuri, do të mbahej në dt. 23.09.2015, ora 11:00, në ambientet e institucionit.

Por, nga dokumentacioni i administruar nuk provohet që nëpunësja ***** të ketë marrë dijeni për këtë akt, pasi mungon konfirmimi i marrjes dijeni prej saj. Duke mos u kryer ky detyrim ligjor, për njoftimin e fillimit të ecurisë disiplinore brenda afateve të përcaktuara në Vendimin Nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjes në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*” dhe Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike, “*Për elementët kryesore procedurale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*”, është shkelur e drejta e saj e ligjshme, për të pasur kushtet dhe kohën e nevojshme për të realizuar mbrojtjen.

Në vijim të procedurës, në datën 23.09.2015, është zhvilluar seanca dëgjimore, dhe është mbajtur një procesverbal i seancës dëgjimore, i cili nuk është i nënshkruar nga nëpunësja e proceduar. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga gjithë pjesëmarrësit në takim, dhe në mënyrë të posaçme nga nëpunësi i proceduar, për të mundësuar transparencën e procesit dhe të drejtën e nëpunësit për t’u njohur me ç’ka është pasqyruar në përmbajtjen e këtij akti.

Pavarësisht kësaj, në përfundim eprori direkt, me vendimin nr. 762, datë 28.09.2015, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*” ndaj nëpunëses *****. Bashkëlidhur vendimit është një shkresë me nr. 24516/7, dt 28.09.2015, me të cilën i dërgohet vendimi nëpunëses së proceduar, por edhe ky akt nuk provohet t’i jetë komunikuar në kohë nëpunëses në procedim e për më tepër nga dokumentacioni i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rezulton që për këtë vendim janë sjellë dy akte me numër protokollit të ndryshëm. Një akt mban nr. 562 vendimi, ndërsa akti tjetër mban nr. 762 vendimi, të cilët kanë të njëjtën përmbajtje.

- Më pas, me shkresën nr. 21636/3 prot., datë 01.10.2015 “*Fillim ecurie disiplinore*” të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ka filluar përsëri ndaj kësaj nëpunëseje një procedim tjetër disiplinor, duke përcaktuar zhvillimin e seancës dëgjimore në dt. 07.10.2015, ora 10.00, në ambientet e institucionit.

Edhe në këtë rast, nga dokumentacioni i administruar, nuk provohet që nëpunësja ***** të ketë marrë dijeni për këtë akt, pasi mungon konfirmimi i marrjes dijeni prej saj. Pretendohet se, nëpunësja *****, është njoftuar për ditën dhe orën e seancës dëgjimore, përmes postës elektronike, në dt. 05.10.2015, nga një specialist i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Por ky njoftim është në shkelje të afateve të përcaktuara në aktet ligjore të sipërcituara, pasi në to sanksionohet se Kryetari i Komisionit Disiplinor (*ky i fundit, i ngritur me aktin nr. 29506 prot., dt. 01.10.2015*), njofton, me një nga mjetet e komunikimit të përcaktuar në ligj, ose akte të tjera rregullatore, nëpunësin në procedim disiplinor, brenda 3 (tre) ditëve nga momenti i marrjes së kërkesës nga eprori direkt i cili kërkon fillimin e procesit disiplinor.

Megjithatë, edhe në këtë rast, njoftimi për fillimin e procedimit disiplinor është realizuar në datën 05.10.2015, ndërkohë që seanca dëgjimore ishte caktuar në datën 07.10.2015. Pra, nëpunësja në fjalë, për të përgatitur observacionet rreth shkeljeve të pretenduara, ka pasur vetëm dy ditë nga

katër ditë që përcaktojnë aktet ligjore për limitet kohore. Në këtë rast, nga ana e D.P. Tatimeve rezulton se është shkelur edhe afati i dytë për dhënien e kohës së mjaftueshme për tu mbrojtur.

Me vendimin nr. 885, datë 19.11.2015, Komisioni Disiplinor ka vendosur dhënien e masës disiplinore *“Pezullim nga ngritja në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës, për një periudhë 6 (gjashtë) mujore”*. Bashkëlidhur vendimit, është një shkresë me nr. 21636/4 prot., dt 19.11.2015, me të cilën i dërgohet vendimi nëpunëses në procedim, por edhe nga ky akt nuk provohet marrja dijani e nëpunëses për vendimin, pasi mungon nënshkrimi i saj për marrjen dijani, duke u shkelur edhe kjo kërkesë e ligjit.

- Gjatë kohës që vazhdonte procesi i mësipërm disiplinor, është iniciuar një ecuri tjetër nëpërmjet memos informuese nr. 20387/5 prot., datë 03.11.2015. Nga dokumentacioni i administruar, përsëri nuk rezulton i provuar fakti, që nëpunësja ***** të ketë marrë dijani për këtë akt, brenda afatit tre ditor të përcaktuar nga ligji pasi, memo informuese nr. 20387/5 prot., ka dalë në datën 03.11.2015, ndërsa njoftimi elektronik për nëpunësen në procedim është dërguar në datën 20.11.2015, pra 17 ditë mbas daljes së aktit për fillimin e ecurisë disiplinore.

Në datën 25.11.2015 është zhvilluar seanca e parë dëgjimore dhe nga institucioni është dërguar me cilësinë e provës shkresore procesverbali, i cili përsëri nuk është i nënshkruar nga nëpunësja në procedim. Duke analizuar përmbajtjen e procesverbalit dhe përmbajtjen e observacioneve të paraqitura nga nëpunësja ***** para Komisionit Disiplinor, vërehen mospërputhje të qëndrimeve të saj. Në kushtet kur procesverbali mbahet me shkrim për të pasqyruar në mënyrë të përmbledhur, çfarë ka ndodhur në seancën dëgjimore, ky akt duhet të firmoset nga të gjithë pjesëmarrësit dhe sidomos, nga nëpunësi në procedim, kjo, për të mundësuar transparencë dhe për të siguruar vërtetësinë e përmbajtjes së procesverbalit.

Komisioni Disiplinor ka shtyrë mbas 33 ditëve seancën dëgjimore, me motivacionin se i duhej dhënë mundësi dhe kohë e nevojshme anëtarëve të Komisionit Disiplinor, të njihen me materialet dhe provat shkresore të administruara.

Përfundimisht, Komisioni i Disiplinës, me vendimin nr. 1033, datë 30.12.2015, ka dhënë masën disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”* të punonjësës *****. Ky vendim shoqërohet me shkresën nr. 20837 prot., dt 30.12.2015, me të cilën pretendohet se nëpunëses i është dërguar vendimi. Por edhe në këtë rast mungon konfirmimi i kësaj të fundit për marrjen e njoftimit sipas afatit të përcaktuar në pikën 20 të Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”*.

Pra, siç përshkruhet dhe analizohet më sipër, rezulton se në kryerjen e këtyre veprimeve administrative, janë lejuar e kryer një sërë parregullsish, që kanë të bëjnë me dokumentimin e tyre, me njoftimin e akteve pjesë përbërëse të këtyre veprimeve, me respektimin e afateve dhe rregullave ligjore që sigurojnë transparencën e duhur dhe garantojnë mundësinë e mbrojtjes së të drejtave të nëpunësit civil.

Por nga ana tjetër, rezulton se ndërkaq, për zgjidhjen e këtyre problemeve, ajo i është drejtuar, me dy kërkesëpadi, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, përmes së cilave kërkon shfuqizimin e akteve administrative:

- ✓ Vendimit nr. 885, datë 19.11.2015, *“Pezullim nga ngritja në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 6 (gjashtë) mujore”*
- ✓ Vendimit nr. 1033, datë 30.12.2015, *“Largim nga shërbimi civil”*.

Aktualisht, rezulton se të dyja këto çështje administrative janë duke u shqyrtuar prej kësaj gjykate. Në këto rrethana, konkludoj se, referuar nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon parimin e moslejimit të shqyrtimit nga institucionet e tjera, të çështjeve që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, duhet të vendoset përfundimi i procedimit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të nenit 103 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ, të iniciuar me Urdhërin e verifikimit nr. 39/1, datë 22.01.2016. *“Për verifikimin e informacionit të ardhur nga një nëpunëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me parregullsi të pretenduara gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore”*.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Departamenti i Administratës Publike si dhe kërkuesja *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA